



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

## NJOFTIM

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.498 prot.i AK, datë 26.11.2021 “Përqendrimi ndërmjet A4nXT GmbH, Lufthansa Industry Solutions AS GmbH / Joint Venture”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me synimin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë A4nXT GmbH dhe Lufthansa Industry Solutions AS GmbH.

Referuar “Marrëveshjes për sipërmarrjen e përbashkët” palët janë:

**Pala 1:** A4nXT GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: blerjen, mbajtjen, administrimin dhe shitjen e investimeve kryesisht në shoqëri vendase ose shoqëri të të gjitha llojeve, si dhe mbështetjen dhe këshillimin, duke përfshirë marrjen përsipër të shërbimeve për këto shoqëri dhe AUDI AG.

A4nXT GmbH është një filial i zotëruar indirekt nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruara indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

**Pala 2:** Lufthansa Industry Solutions AS GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: ofrimin e shërbimeve IT, veçanërisht zhvillimi i softuerëve, si dhe i shërbimeve si p.sh. konsultimi, shërbimet e infrastrukturës dhe shërbimet e komunikimit.

Lufthansa Industry Solutions AS GmbH është një filial i zotëruar plotësisht nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Grupit Lufthansa.

Grupi Lufthansa është prezent në tregun shqiptar nëpërmjet: Degës në Shqipëri Deutsche Lufthansa, Lufthansa Industry Solutions SHPK, Degës në Shqipëri Austrian Airlines dhe Degës në Shqipëri Austrian Airlines AG.

**Ndërmarrja e përbashkët (JV)** do të themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit gjerman, me selinë e saj në Mynih, Gjermani. JV do të ofrojë shërbime konsulence IT dhe shërbime ndihmëse IT për palët e treta.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**